



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 23
Prishtinë, më 11 mars 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301
Mbledhja filloi në orën 13:00

P R O C E S V E R B A L
I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Në mbledhje morën pjesë: Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj, Bojan Stojanović, Emrush Xhemajli, Ibrahim Selmanaj, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu, Melihate Termkolli, Agim Veliu dhe Gani Geci.

Mungoi: Zulfi Merxha.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Antigona Ibraj dhe Blerina Pula.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Njoftim nga përfaqësuesi i EULEX-it
3. Miratimi i procesverbalit të 25 shkurtit 2009
4. Shqyrtimi i fushëveprimit të Komisionit
5. Shqyrtimi i Ligjit për tubimet publike
6. Të ndryshme

***Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Njoftim nga përfaqësuesi i EULEX-it

Kryetari – I nderuari z. Lukas, përfaqësues i EULEX-it, Komisioni ka shprehur interesim të dëgjojë nga ju për gjendjen e sigurisë në vendin tonë, posaçërisht për

shtrirjen e misionit të EULEX-it. Ju do ta keni fjalën, pastaj anëtarët e Komisionit do të parashtrajnë pyetje.

Lambert Lukas - përfaqësues i misionit të EULEX-it në Kosovë - E falënderoi Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, që ia ka dhënë mundësinë t'i drejtohet Kuvendit të Kosovës. Në paraqitjen e tij tha: Më duhet t'jua sqaroj se misioni i EULEX-it është mision i sundimit të ligjit. Gjithashtu bëri edhe një përshkrim të strukturës së EULEX-it për departamentet e ndara, për funksionet që kryhen në to dhe i paraqiti disa të dhëna të përgjithshme statistikore. Të gjitha këto do të përfshihen në një raport të veçantë.

3. Miratimi i procesverbalit të 25 shkurtit 2009

Procesverbali i datës 25 shkurt 2009 u miratua pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i fushëveprimit të Komisionit

Kryetari i Komisionit - Ne në mbledhjen e kaluar i kemi paraqitur disa vërejtje. Ato janë përfshirë dhe tani duhet ta përcaktojmë fushëveprimin e Komisionit. A ka dikush diçka për të shtuar?

Gani Geci - Ne i kemi miratuar ligjet për shpërbërjen e TMK-së dhe për formimin e FSK-së. Mendoj se më nuk duhet të përdoret fjala proces, por vetëm fjala shpërbërje.

5. Shqyrtimi i Ligjit për tubimet publike

Kryetari i Komisionit – Ju e dini se ky ligj është kthyer nga kryetari i Kosovës. Ne e kemi caktuar referues për shqyrtimin e këtyre vërejtjeve z. Agim Veliu, i cili bashkë me grupin e punës i ka shqyrtuar dhe i ka sjellë amendamentet e propozuara. A pajtoheni me këto amendamente?

Anëtarët e Komisionit i miratuan propozimamendamentet e Ligjit për tubimet publike.

6. Të ndryshme

Për këtë pike nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15.

Përgatiti:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Rrustem Mustafa

Kryetar i Komisionit